



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.343/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e BIRN dhe Internews, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,500.00 (dymijë pesëqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e promovimit të subjektit politik dhe kandidatit duke përdorur – ekspozuar, personat nën moshën 15 vjeçare, me qëllim të përfimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021.

II. Detyrohet Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 05.02.2021, me të cilën pretendon se kandidati për deputet Kastriot Berisha, nga radhët e subjektit politik AAK, në postimin e tij në rrjetin social Facebook, ka publikuar një fotografi në të cilën është i përfshirë një i mitur së bashku me kandidatin për deputet Kastriot Berisha dhe bartësin e listës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë kandidati për deputet Kastriot Berisha nga radhët e subjektit politik AAK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes dhe Rregullat Zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, parashtruesi i ankesës BIRN ka bashkangjitur dy fotografi, nga postimet ku përfshihet i mituri në materiale promovuese politike të fushatës zgjedhore, ku shihet i mituri dhe ora e saktë se kur është shfaqur ky postim si dhe fotografia e plotë me përshkrim mbi të.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.02.2021, subjekti politik AAK thekson se i mituri i përfshirë në fotografinë e postuar në Facebook është fëmijë-djali i kandidatit për deputet Kastriot Berisha, i njëjti ka qenë i shoqëruar nga prindi i tij Kastriot Berisha dhe se kandidati

për deputet Kastriot Berisha ka ndërmarrë masa të menjëhershme për të bërë përmirësimin e shkeljes së pretenduar ashtu që me datë 05.02.2021 para orës 16:00 e ka fshirë fotografinë me djalin e tij të mitur të publikuar në Facebook.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi ka bashkangjitur foto të postimeve në faqen e tij zyrtare në Facebook në të cilat postime nuk figurojnë dy fotot e mëparshme të tij ku përfshihej kandidati Kastriot Berisha dhe i mituri në materiale promovuese politike të fushatës zgjedhore. Subjekti politik AAK ka kërkuar nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga “BIRN & Internews Kosova” të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Kastriot Berisha, nga radhët e subjektit politik AAK, ka përdorur fëmijë për fushatë zgjedhore duke postuar në rrjetin social Facebook. Veprim ky që është në kundërshtim me nenin 2 pika 5.3 e Riformular pika b), c) dhe d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019, mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, personat nën 18 vjet, bartin material promovues gjatë fushatës zgjedhore.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 2 par. 3, pika b), c) dhe d) dhe neni 2 par. 4 të Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që fëmija i mitur është në fotografinë e publikuar, që identifikohet subjekti i caktuar politik, e cila fotografi ka për qëllim promovimin e subjektit politike AAK.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik AAK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe

përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat e mitur, në kundërshtim me dispozitat e lartë cekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se e ka pranuar shkeljen dhe e ka bërë përmirësimin e shkeljes, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 343/2021 më datën 08.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Adem



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.